



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:294458
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05622743

PPP.nr.39/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil përbarimore, me gjyqtarin Genc Hasani, me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Berisha, në çështjen juridike të kreditores Sh. B., të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Namon Merovci avokat në Vushtrri, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Avokat Lirim Zeka nga Prishtina, për shkak të borxhit, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me datë 06.04.2024 kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.64/24 të datës 20.02.2024, gjykata jashtë seancës gjyqësore me datë 25.04.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tersi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Mitrovicës, ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.64/24 të datës 20.02.2024, sipas propozimit të kreditores Sh. B., nga M.

II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e debitorit Komuna e Mitrovicës, lidhur me bashkimin e lëndës P.nr.64/24 të datës 20.02.2024, sipas propozimit të kreditores Shukrije Breznica nga Mitrovica, me lëndët e lejuara me Urdhër Përbarimor P.nr.67/24, P.nr.66/24, P.nr.65/24 dhe P.nr.63/24, te propozuesve – kreditorëve Nisret Klinaku, Bukurije Behrami – Uka, Merita Fejza, dhe Dafina Jashari nga Mitrovica.

A r s y e t i m

Kreditorja Sh. B., ka ushtruar propozimin për përbarim tek përbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, në bazë të dokumentit përbarimor-Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë me numër C.nr.1866/2021 të datës 18.01.2024, me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 860 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën 70.40€, shpenzimet e përpilimit të propozimit për përbarim sipas tarifës së Odes së Avokateve me në shumën prej 156€, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat (7) ditor nga dita e dorëzimit të propozimit për përbarim, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përbarim të datës 20.02.2024.

Përbaruesi privat me urdhrin P.nr.64/24 të datës 20.02.2024, ka lejuar përbarimin në këtë çështje.

Debitori Komuna e Mitrovicës, brenda afatit ligjor me datë 06.03.2024 ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrat përmbartimor, si dhe kërkesë për bashkim të lëndëve duke theksuar se i autorizuar i kreditorëve ka përpiluar disa propozime për përmbartim në bazë të një Aktgjykimi me numër C.nr.1866/2021 të datës 18.01.2024, ndërsa përmbartuesi privat ka nxjerr urdhra për lejimin e përmbartimit në bazë të aktgjykimit të lartcekur dhe atë P.nr.67/24, P.nr.66/24, P.nr.65/24, P.nr.64/24, P.nr.63/24, sipas propozimit të kreditorëve, andaj përpilimi i disa propozimeve për përmbartim në bazë të një dokumenti përmbartimor shkakton shpenzime të panevojshme në emër të procedurës përmbartimore si dhe në emër të taksës gjyqësore në këtë rast, përfaqësuesi i palës dyfishon shpenzimet e procedurës të cilat i vihen si detyrim debitorit. Tutje i njëjti thekson se në mbështetje të nenit 17 të Ligjit për procedurën përmbartimore parasheh se *“Në procedurën përmbartimore përshtatshëmish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, po që se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”* kjo do të thotë se parimet e përcaktuara me këtë Ligj vlejnë edhe në procedurën përmbartimore. Duke u thirrur në parimin e shfrytëzimit me mirëbesim të të drejtave procedurale dhe parimin e ekonomisë së procedurës së Gjyqimit. Debitori në rastin konkret ka theksuar se Përmbartuesi Privat me caktimin e dy urdhrave përmbartimor ka shkelur parimet e caktuara me nenin 9 dhe 10 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Andaj, i kanë propozuar gjykatës me qëllim të respektimit të parimeve dhe depozitave ligjore lidhur me procedurën përmbartimore të bëjë bashkimin e propozimeve për përmbartim të cilat janë në bazë të një dokumenti përmbartimor në këtë rast Aktgjykimit C.nr.1866/2021 të datës 18.01.2024, pasi që përpilimi i propozimeve lidhur me një aktgjykim është në kundërshtim me dispozitat ligjore, po ashtu ka kërkuar të anulohet pjesërisht urdhri përmbartimor sa i përket pikës I të propozimit për përmbartim.

Kreditori përmes të autorizuarit ka paraqitur përgjigje dhe ka kërkuar nga gjykata që ti refuzoj në tersi prapësimin dhe kërkesën e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohet përmbartimi i lejuar nga kjo gjykatë.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret në atë se përfaqësuesi i kreditorit ka paraqitur disa propozime dhe atë për kreditorët Sh B, nga M. në bazë të Aktgjykimit me numër të lëndës C.nr.1866/2021 të datës 18.01.2024, si dhe përmbartuesi privat me urdhrat përmbartimor P.nr.67/24, P.nr.66/24, P.nr.65/24, P.nr.64/24, P.nr.63/24, sipas propozimit të kreditorëve, ka lejuar përmbartimin dhe kjo përbën shkelje të dispozitave ligjore pasi që përfaqësuesi i kreditorëve është dashur të paraqes një propozim të vetëm për përmbartim sepse me këtë do të shkaktonte me pak shpenzime debitorit si dhe i njëjti ka kërkuar që të bëjë bashkimin e propozimeve për përmbartim meqenëse që të pese propozimet bazohen në të njëjtin aktgjykim, gjykata një pretendim të tillë të debitorit Komuna Mitrovicës e refuzoj në tërësi si të pabazuar, duke qene se nuk i ndalohet Kreditorit në rastin konkret që të paraqesë propozim për përmbartim, e as Përmbartuesi Privat në rastin konkret të lejoje përmbartimin dhe të nxjerre Urdhër Përmbartimor.

Nenit 17 i Ligjit të Procedurës Përmbaremore parasheh se *“Në procedurën përmbaremore përshtatshmërisht zbatohet dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontesti morë, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, ndërsa neni 408 i LPK-së parasheh se *“Po qe se në të njëjtën gjykatë janë në zhvillim e sipër dy apo më tepër gjykime ndërmjet personave të njëjtë, apo në të cilat i njëjti person është kundërshtar i paditësve apo të paditurve të ndryshëm, gjykata mund t’i bashkojë të gjitha ato me aktvendim me qëllim të shqyrtimit të përbashkët, nëse me një gjë të tillë do të zvogëloheshin shpenzimet dhe do të përshpejtohej shqyrtimi i çështjeve. Për të vepruar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nevojitet pëlqimi i palëve“*, ndërsa në rastin konkret pëlqim të palëve nuk kemi pasi që kreditori nuk e ka dhënë pëlqimin. Po ashtu gjykata e refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar pasi që vlerësoi se me rastin e inicimit të procedurës përmbaremore në përpikëri janë respektuar dispozitat e nenit 21, 22, 36, 38 dhe 43, ku në nenin 21 parashihet se: bazat juridike për caktimin e përmbaremit *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, dhe nenin 43 parasheh se Aktvendimi për përmbareim dhe urdhri për përmbareim 1. *“Në aktvendimin për përmbareimin dhe urdhrin për përmbareim në bazë të titullit përmbareues duhet të tregohet dokumenti përmbareues, kreditori dhe debitori i përmbareimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbareimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbareimit”*. Gjykata po ashtu vendimin e saj e bazoi edhe në dispozitën e nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1, ku parashihet që 1. Dokument përmbareues është: 1.1. *“vendimi përmbareues i Gjykatës”*.

Vendimin e saj si në pikën I të dispozitivit të aktvendimit gjykata e bazoi edhe në nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së cituar *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërsi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se *“kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet në përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkoj edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”*.

Vendimin si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit e bazoi në nenin 17 të LPP-së, e në lidhje me nenin 408 të LPK-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.39/24, datë 25.04.2024

GJYQTARI,
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate, vetëm sa i përket pikës I të dispozitivit të këtij aktvendimi, ndërsa ndaj pikës II të dispozitivit të këtij aktvendimi, nuk lejohet ankesa.